

Analiza&Komente

Edukimi profesional apo universitar?

Bahri Sejdiu

Saltonet e së marrës janë në marnë lavare të Institutit Demokratik për Zhvillim (D4D). Saloni ka format gjashtëherë mal sipas rregullës Chatham House dhe përpara të mediave Diskutimi mbledhë rreth vetes ekspertë e analistë politikanë e publiciste për të reflektuar dhe kërkuar konsensus rrebi format e përzhvenditura. Fjala e hapjes pastohet në katalin e salloneve në "You Tube". Secili Saloni përçillet në editorial të publikohet në "Zëri" të martën e ardhshme dhe në faqen elektronike të D4D-se. Podcastat bëhen të editorial mund t'i gjeni në webfaqen tonë. Saloni i radhës do të mbahet sot më 23 maj 2017 nga ora 16:45 në DIT' e Nat' me temën "Roli i mediave në këto zgjedhje A ndikojnë në votën e qytetarëve?"

Dilemat e rinisë kosovare në ditët e sotme janë edukimi profesional apo universitar? Përvojat e deritanishme kanë dëshmuar se çdo investim në sektorin e arsimit ndikon në zhvillimin e vendit. Pavarësisht dilemave se "papunësia" dhe "varfëria" janë në rritje, të rinjtë e Kosovës janë optimistë për të ardhmen. Sfidat kryesore për shoqërinë kosovare mbetet planifikimi dhe implementimi i programit të mirëfilltë në arsimimin dhe aftësimin profesional. Mësimi gjatë gjithë jetës është i rëndësishëm themelore për punësim, zhvillim ekonomik dhe mundësi e hapur për integrim në shoqëri. Ndryshe, sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës numri i të papunëve është 32,9%, ndërsa komuniteti i biznesit dhe sindikata e punës kanë thënë se ky numër është dukshëm më i madh, duke kaluar 40%.

Në Kosovë mungon një orientim profesional drejt ekonomisë së tregut, me anë të cilit u tregohet të rinjve se sa kuadro kërkohen nëse duhet kryer një shkollë profesionale ose një fakultet. Kohëve të fundit mijëra të rinj mësyjnë shtetet perëndimore. Në anën tjetër këto shtete dëshirojnë njëri të kualifikuar e jo njëri që vijnë nga halli. Arsimit dhe aftësimi profesional konsiderohen si nolinika të BE-së për t'u bërë ekonomi

mesme të larta, shumë universitete publike dhe private me shumë kuadro kuantitative, të profesioneve të ndryshme, që kryejnë punë joprofessionale. Me fjalë të tjera, ai-ajo që ka kryer studimet për master në histori, ose drejtim tjetër, punon në ndonjë market apo punë tjetër që as përfaqësohet nuk kanë asgjë të përbashkët. Mandej, "fabrikimi" i diplomave, ku në sektorin publik punësohen të afërmit e njerëzve të politikës, krijon parregullsi në arsim dhe në administratë publike.

Gfarë duhet bërë? Orientimi me kohë, qoftë nga prindërit apo mësimdhënësit, për profesionin pas përfundimit të shkollimit fillor të fëmijëve. Orientimi për shkollat profesionale, të cilat duhet të funksionojnë si ndërmarrje të vogla ekonomike, e që janë shtyllat kryesore për zhvillimin e ndërmarrjeve të ardhshme, prodhuese dhe shërbëse. Shembulli më i mirë është Qendra e Kompetencës në Skenderaj, e cila ofron kushte për aftësim profesional për tregun e punës. Në këtë shkollë funksionojnë shumë profile, duke filluar nga ndërtimtaria e ulët, arkitektura, deri të dizajni i modës, që është bërë shumë tërheqës për gjininë femërore. Kohëve të fundit është thyer tabuja se në këtë shkollë shkojnë vetëm nxënësit e dobët

shme të Kosovës dhe të Shqipërisë. Mandej, rreth 49% janë punësuar në ndërmarrje të vogla apo të mesme. Rreth 25% janë regjistruar në fakultete të ndryshme. Qëllimi nuk është për t'i nënçmuar gjimnazet dhe shkollat tjera, por udhëzimi në karrierë ka rëndësi të madhe. Shkollat profesionale, krahasuar me shkollat tjera, janë një mundësi e mirë për kualifikimin e fuqisë punëtore, rritjen e punësimit tek të rinjtë dhe zhvillimin e vendit në përgjithësi. Debatet e ndryshme që bëhen me të rinj janë të mirëseardhura për hapat e mëtejshëm në karrierë. Kjo është lidhja më e mirë në mes të arsimit dhe aftësimin profesional, në pajtim me kërkesat e tregut të punës. Mosekzistimi i lidhjes në mes të shkollave profesionale dhe sektorit të ekonomisë e minon tërësisht konceptin e arsimit dhe aftësimin profesional. Në të ardhmen mbetet edhe shumë punë për t'u kryer. Ministria e Arsimit e drejtoritë komunale të arsimit duhet ta kenë parasysh ofrimin kushteve për punë praktike, t'u ofrojnë autonomi buxhetore dhe procedurave të panevojshme të prokurimit dhe të krijojnë bashkëpunim me bizneset ekzistuese. Së fundit, duhet bërë depolitizimi, meritokracia, profesionalizmi, etika e përgjegjësia institucionale janë kushte që